



OSHP: 2025/1232

Vendim

2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., lidhur me aktiviteti i prokurimit FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%) me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik PATRONI SH.P.K.

Arsyetim

Me 18.01.2025 KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%) me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 6,650,000.00 €.

Me 03.12.2025 KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është anuluar aktiviteti.

Me 08.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 11.12.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.12.2025, OE PATRONI SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1232, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues PATRONI SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Kronologji

Fillimisht, njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte bërë me datë 25.03.2024, ku ishte rekomanduar për kontratë OE Ex Fis SHPK me çmim prej 109.00 € dhe total prej 6,381,572.14 €. Neve kishim pranuar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Pastaj, me datë 02.04.2024 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Kërkesa për rishqyrtim ishte aprovuar dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim.

Prej datës së aprovimit të kërkesës për rishqyrtim, pra prej datës 05.04.2024, deri më datë 22.05.2024 nuk ishte kryer rivlerësimi dhe rishqyrtimi, ku çështja e vetme që ishte rishqyrtuar ka qenë nënshkrimi i deklaratës për afat të liferimit dhe paramasës dhe përshkrimi i çmimeve pa autorizim.

Më pas ishte publikuar njoftimi mbi vendimin me datë 22.05.2024, ku përsëri ishte rekomanduar për kontratë i njëjti operator ekonomik.

Pas kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP, ishte nxjerrë vendimi i panelit shqyrtues me datë 19.08.2024, Nr. 2024/0513, ku ishte aprovuar ankesa si e bazuar, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ishte shpallur i papërgjegjshëm.

Më poshtë po citojmë konstatimet e panelit shqyrtues në lidhje me nënshkrimet e kontestuar.

Paneli shqyrtues konkretisht ka vërejtur se nënshkrimet tek deklaratat në betim, deklaratat për specifikime teknike dhe deklaratat e prodhuesit janë të Drejtorit Lum Muharremi, kurse tek deklaratat për afat të liferimit dhe nënshkrimi tek paramasa me përshkrim të çmimit nuk janë identike me nënshkrimin e Drejtorit, pra ndryshojnë dhe ka mospërputhje të nënshkrimeve tek

dokumentet e prezantuara në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Sa i përket nënshkrimeve të vendosura në dy dokumentet e kontestuara, përkatësisht tek deklarata për afat të liferimit dhe tek paramasa me përshkrim të çmimit, paneli shqyrtues ka analizuar këto dy nënshkrime dhe ka ardhur në përfundim se autoriteti kontraktues e as eksperti shqyrtues nuk kanë dëshmuar se nënshkrimet e vendosura në këto dy dokumente janë të personit për të cilin pretendon OE i rekomanduar për kontratë dhe për të cilin ka bashkëngjitur një autorizim me rastin e sqarimeve shtesë.

Madje eksperti shqyrtues edhe në seancën dëgjimore të datës 14.08.2024 nuk ka marrë përgjegjësinë se janë vërtetuar nënshkrimet e këtyre dy dokumenteve dhe nuk ka marrë përgjegjësinë se këto dy nënshkrime janë të personit për të cilin OE i rekomanduar për kontratë ka bashkëngjitur autorizimin me sqarime shtesë.

Për më tepër, gjatë analizës së nënshkrimeve të këtyre dy dokumenteve, paneli shqyrtues ka vërejtur se nënshkrimet në këto dy dokumente nuk janë të vendosura në formatin dhe mënyrën e njëjtë, pasi që tek paramasa me përshkrim të çmimit, tek rubrika e nënshkrimit është shënuar fjala “për” dhe është vendosur nënshkrimi i cili nuk është vërtetuar as nga autoriteti kontraktues e as nga eksperti shqyrtues se i cilit person është.

Ndërsa tek deklarata për afat të liferimit, tek rubrika e nënshkrimit është vendosur nënshkrimi i njëjtë sikurse tek paramasa me përshkrim të çmimit, mirëpo në këtë rubrikë e as në rubrikat tjera nuk është vendosur fjala “për”, dhe kjo për panelin shqyrtues dëshmon parregullsi të nënshkrimit të këtyre dokumenteve, përkatësisht mënyrës së nënshkrimit të këtyre dokumenteve dhe dëshmon pamundësinë e vërtetimit nga ana e AK-së dhe e ekspertit shqyrtues të këtyre nënshkrimeve.

Për më shumë, në lidhje me autorizimet për nënshkrim të dokumenteve të tenderit, KRPP ka lëshuar një opinion me datë 24.10.2023, tek pyetjet e shpeshta, përkatësisht pyetja nr. 14, ku ka sqaruar se domosdoshmërisht për t'i nënshkruar dokumentet e tenderit një person tjetër duhet të jetë i autorizuar për këtë qëllim, ndërsa në rastin konkret nuk është dëshmuar dhe vërtetuar nga autoriteti kontraktues e as nga eksperti shqyrtues se nënshkrimi i dy dokumenteve është i personit të autorizuar, prandaj ky fakt për panelin shqyrtues dëshmon papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë dhe nevojën që AK-ja të veprojë konform nenit 52.7 të LPP-së.

Nga konstatimet e lartcekura në vendimin e OSHP-së kuptohet se AK-ja kishte vepruar në kundërshtim me vendimin e panelit shqyrtues të datës 19.08.2024, Nr. 2024/0513, dhe me këtë rast është vepruar edhe në kundërshtim me nenin 97.1 pika (h) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, pasi që ky veprim përbën shkelje të rëndë. Ky veprim sanksionohet me revokim të certifikatës së prokurimit për ZPP, siç parashihet në nenin 99 të RRPP Nr. 001/2022.

Pastaj, njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me datë 23.09.2024, duke mos respektuar vendimin e panelit shqyrtues, ndërsa ne me datë 25.09.2024 kemi kërkuar qasje në dokumente, ku me datë 26.09.2024 na është lejuar qasja, ku kemi vërejtur se AK-ja me datë 13.09.2024 ka kërkuar sqarime përsëri nga OE i rekomanduar për kontratë Ex Fis, kurse i njëjti ka dhënë përgjigje me datë 16.09.2024 duke thënë se nënshkrimi në dokumentet e kontestuara është i Fatbardh Muharremi.

Edhe me këto sqarime nuk është bashkëngjitur ndonjë dëshmi tjetër shtesë për të konfirmuar nënshkrimet e kontestuara, por vetëm është bashkëngjitur edhe një herë autorizimi i cili ishte

bashkëngjitur edhe në sqarimet e mëhershme. Pra, nuk ka asnjë dëshmi tjetër shtesë dhe konkrete për të vërtetuar nënshkrimet e kontestuara, por vetëm pohime dhe fjalë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, si dhe pas shqyrtimit tërësor të dokumentacionit të lëndës, përfshirë analizimin në detaje të specifikimit teknik të dosjes së tenderit, Komisioni i Rivlerësimit, duke marrë parasysh edhe dispozitat e nenit 67.7 të RRPP-së, ku thuhet se: “Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar”, vlerëson se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Në këtë drejtim, dhe në përputhje me nenin 62 të LPP-së, Komisioni Profesional i Rivlerësimit, përkatësisht Autoriteti Kontraktues, ka vlerësuar se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet për arsyet në vijim:

Në faqen nr. 19, me titull Aneksi 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, në përshkrim është kërkuar mazuti si lëndë djegëse dhe në tabelë janë shënuar të dhënat teknike që duhet të plotësohen nga ofertuesit potencialë. Komisioni ka vërejtje të theksuara ndaj këtij specifikimi teknik, sepse nuk është e mundur që këto kritere të kenë vlera të njëjta dhe fikse për dy lloje të mazutit, siç është dhënë në përshkrim.

Mazuti i rëndë dhe mazuti i mesëm, sipas përshkrimit teknik, janë paraqitur me vlera të barabarta për këta parametra:

vlera kalorifike për të dy llojet e mazutit është kërkuar të jetë 9500 kcal/kg;

dendësia në 15°C për të dy llojet e mazutit është kërkuar të jetë 0.95 kg/dm³;

vlera e hirit, po ashtu për të dy llojet e mazutit, është kërkuar të jetë maksimum 0.2%.

Në specifikimin teknik të detyrueshëm ka gabime teknike dhe këto gabime duhet të evitohen në dosjen e tenderit për kërkesat e ardhshme, sepse vlera kalorifike, së paku, duhet të kërkohet me toleranca dhe jo si vlerë fikse.

Po ashtu, në faqen nr. 16, Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, pika 7.1 dhe 7.2, nuk është kërkuar që mazuti që do të liferohet të ketë certifikatë nga laborator i prodhuesit, në mënyrë që të dihen të gjitha shënimet themelore teknike për mazutin që do të liferohet.

Pra, në specifikimin teknik të dosjes së tenderit ka gabime të rëndësishme përmbajtësore. Me këto vlera fikse teknike, kontrata është e përealizueshme në praktikë. Specifikimi teknik i parashtruar paraqet kufizime thelbësore për zbatimin e kontratës, prandaj Komisioni Teknik rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, në mënyrë që gjatë ri-tenderimit të bëhen përmirësimet e nevojshme dhe vlerat teknike të përcaktohen me toleranca të pranueshme.

Vlen të theksohet se, nëse operatori ekonomik ankues do të kishte konsultuar apo angazhuar ekspert të fushës, lehtësisht do të vërtetohej se me këta parametra të përcaktuar gabimisht është e pamundur të sigurohet performancë e mirë dhe realizim i suksesshëm i kontratës.

Në përfundim, Komisioni i Rivlerësimit, pas analizimit tërësor të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit dhe duke marrë parasysh gabimet përmbajtësore të specifikimit teknik, të cilat në këtë

fazë nuk mund të korrigojen, në pajtim me nenin 62, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, rekomandon që aktiviteti i prokurimit të anulohet dhe që gjatë ri-tenderimit të përgatitet një specifikim teknik me parametra dhe toleranca adekuate.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1232, ndërsa me datë 29.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1232, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEPATRONI SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1232 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim per PSH: Eksperti shqyrtues sqaron se per kete aktivitet te prokurimit eshte marre vendimi me nr. 2024/513 - 1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “PATRONI” SH.P.K., me nr. 2024/0513, e dates 14/06/2024, ndërsa, vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Lëndë Djegëse për KaldaJë – Mazut(Fuel Oil 1.0%)”, me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a. anulohet, ndërsa, aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

Vendimi me nr. 2024/970:-

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “PATRONI” SH.P.K. me nr. 2024/0970, e dates 10/10/2024, kurse vendimi i AK “KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES” sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

Vendimi 2025/0095: -

Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-se, lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me nr. të prokurimit: "KEK-24-186-1-1-1", inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA

ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a, nderkaq aktiviteti i prokurimit kthehet ne ri-vleresim.

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me arsyen e anulimit të aktivitetit të prokurimit, dhe pretendimi është se AK, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor, ka marrë vendim për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, përderisa me të njëjtat specifikime ka furnizuar edhe përmes një procedure tjetër të prokurimit ku kontraktor ka qenë OE ankues, si dhe në disa raste edhe OE i rekomanduar për kontratë fillimisht në këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, pas administrimit të provave të ngarkuara në e-prokurim, vendimit 2025/0095 të PSH-së, datë 18.09.2025, dhe hapave të ndërmarra pas këtij vendimi, sqaron se AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimet:

Specifikimi teknik i vitit 2019 dhe 2022 ka përmbajtje të njëjte me ndarje në viskozitet (OE/ cSt) por që është i njëjti me përmbajtje (KEKO-22-120-111) të specifikimit teknik e cila është edhe në këtë aktivitet të prokurimit.

Në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim AK e ka arsyetuar anulimin me kërkesën 7.1 & 7.2 dhe se nuk është kërkuar që mazuti që do të liferohet të ketë certifikatën nga laboratoritë prodhuese, ashtu që të dihen të gjitha shenimet themelore teknike për mazutin që do të liferohet, pavarësisht kësaj me dosje të tenderit dhe me FDT nuk është kërkuar ndonjë dëshmi që ka të bëjë me kualitetin e mazutit që duhet të liferohet pra nuk ka qenë ndonjë kriter për zgjedhje por që është kërkuar me KVK neni 16.2 është kërkuar: “Cilesia e mallit duhet të dëshmohet me certifikatën mbi kualitetin e mallit që duhet të jetë brenda kufijve të lejuar nga dokumentacioni mbi kualitetin e mallit të lëshuar nga laboratoritë e certifikuar”.

Poashtu në Aneksin 1 të Dosjes së tenderit është kërkuar që: “Tenderuesi duhet të plotësojë dhe nënshkruajë identifikimin që nënkupton se mazuti i liferuar do të jetë në pajtueshmëri me të gjitha specifikimet e shënuara në këtë listë”.

Kërkesa në KVK për këtë pikë është në të gjitha aktivitetet e prokurimit, si më poshtë:

KEK-25-5732-1-1-5, KEK-25-9020-1-1-5, KEK-25-10808-1-1-5, KEK-24-12773-1-1-5, KEK-24-10981-1-1-5, KEK-24-8482-1-1-5, KEK-24-6141-1-1-5, KEK-24-15-1-1-5

Ndryshimet e DT-së në këtë fazë janë se është shtuar viskoziteti në 500 E/cst - 98/235 - 13/31

Me tenderin 2025/KEK-25-5732-1-1-5/B52-0014936 AK ka kontraktuar më datën 01.07.2025 OE ExFis me procedurë të negociuar në vlerën prej 592,562.06 €

Me tenderin 2025/KEK-25-9020-1-1-5/B52-0023768 AK ka kontraktuar më datën 08.10.2025 OE ExFis me procedurë të negociuar në vlerën prej 547,819.93 €.

Me tenderin 2025/KEK-25-10808-1-1-5/B52-0028687 AK ka kontraktuar më datën 03.12.2025 OE ExFis me procedurë të negociuar në vlerën prej 264,083.53 €

Kontraktimi i furnizimeve, të cilat kanë pasur të njëjtin specifikim teknik me atë që është në tenderin fillestar, dhe për të cilin tani AK e ka anuluar me arsyetimin se është gabim.

Në këtë aktivitet të prokurimit ndryshimi në specifikim teknik është pjesë e dendësive në 150C derisa është larguar pjesë prej 500C.

Me tenderin 2024/KEK-24-12773-1-1-5/B52-0033279 AK ka kontraktuar më datën 17.12.2024 OE ExFis me procedurë të negociuar në vlerë prej 696,576.54 €. Specifikimi teknik ka qenë me vlera fikse dhe kërkesa për përmbajtjen e hirit është identike.

Me tenderin 2024/KEK-24-10981-1-1-5/B52-0027478 AK ka kontraktuar më datën 25.10.2025 OE ExFis me procedurë të negociuar në vlerë prej 632,298.44 €. Specifikimi teknik ka qenë me vlera fikse dhe kërkesa për përmbajtjen e hirit është identike.

Me tenderin 2024/KEK-24-8482-1-1-5/B52-0021136 AK ka kontraktuar më datën 21.08.2024 OE ExFis me procedurë të negociuar në vlerë prej 570,352.18 €. Specifikimi teknik ka qenë me vlera fikse dhe kërkesa për përmbajtjen e hirit është identike.

Me tenderin 2024/KEK-24-6141-1-1-5/B52-0015693 AK ka kontraktuar më datën 27.06.2024 OE ExFis me procedurë të negociuar në vlerë prej 722,252.80 €. Specifikimi teknik ka qenë me vlera fikse dhe kërkesa për përmbajtjen e hirit është identike.

Me tenderin 2024/KEK-24-15-1-1-5/B52-0000924 AK ka kontraktuar më datën 15.01.2024 OE Patroni me procedurë të negociuar në vlerë prej 211,908.94 €. Specifikimi teknik ka qenë me vlera fikse dhe kërkesa për përmbajtjen e hirit është identike.

AK nuk ka kërkuar asnjë dokument apo dëshmi nga OE për të vërtetuar përputhshmërinë me specifikimet teknike gjatë procesit të tenderimit. Kjo mungesë vlen si për dosjet para kësaj procedure tenderuese, ashtu edhe për dosjet pas saj. E vetmja dëshmi që është kërkuar është certifikata e cilësisë, e cila lidhet me ofrimin/lifërimin e mallrave dhe është pjesë e kushteve kontraktuale, por nuk ndikon në përzgjedhjen e OE-së për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron se aktiviteti i prokurimit për këtë tender është publikuar me datën 16.01.2024. Nga ajo datë, AK ka ekzekutuar edhe tetë aktivitete tjera të prokurimit me procedurë të negociuar, të cilat kanë rezultuar me kontrata. Në pesë nga ato procedura janë kontraktuar me specifikimin në të cilin është kërkuar dendësia në 150C.

Poashtu, pothuajse të gjitha parametrat, të cilat janë përdorur si arsytim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kanë qenë pjesë e aktiviteteve të prokurimit me procedurë të negociuar, të cilat kanë rezultuar me kontrata dhe janë realizuar po me të njëjtin OE ExFis dhe në një rast edhe me OE ankues.

Si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se në këtë aktivitet të prokurimit AK gjatë vlerësimit dhe marrjes së vendimit për anulim e ka arsyetuar vendimin në kërkesa të cilat nuk kanë qenë pjesë e kërkesave të dosjes së tenderit dhe të cilat nuk kanë pas asnjë efekt në vlerësim të ofertuesve apo vendimit për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit. Për më tepër të njëjtin specifikim pa ndonjë ndryshim substancial e ka përdorur për kontraktimin e disa aktiviteteve të njëjta e të cilat janë realizuar pa asnjë vërejtje.

Duke pas parasysh vendimet e meparshme të PSH të OSHP, arsyetimin e dhënë nga AK për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, dosjet e tenderit për të njëjtin aktivitet të prokurimit eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk i ka respektuar vendimet e meparshme të OSHP-se, si dhe anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk është bërë në përputhje me nenin 43 të RRPP 002/2024 duke mos e arsyetuar vendimin me fakte dhe argumente të bazuara prandaj si rezultat eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesave, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues evidenton se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka nxjerr edhe tri vendime paraprake me nr. 2024/0513, 2024/0970, dhe 2025/0095. Në të gjitha këto vendime janë konstatuar shkeljet e autoritetit kontraktues i cili nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të NJK dhe DT. Në të gjitha këto vendime kanë qenë i njëjti OE ankues i cili është edhe tani ankues dhe e ka përsëritur ankesën e tij për herën e katërt me nr. 2025/1232. Paneli Shqyrtues në të gjitha vendimet paraprake ka konstatuar shkeljet të cilat i ka bërë AK. Kështu që, edhe Paneli Shqyrtues në bazë të atyre të gjeturave dhe shkeljeve të AK, aktivitetin e prokurimit tre (3) herë me radhë e ka kthyer lëndën në ri-vlerësim, me qëllim që AK të bëjë ri-vlerësimin e ofertave konform dispozitave ligjore. Lidhur me këtë, Paneli, shpjegon po ashtu se Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe 6 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciues e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish vendimin e saj bazuar në gjetjet e vendimeve paraprake të OSHP.

Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, AK tani ka gjetur se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet. Paneli Shqyrtues potencon se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit të iniciuar në vitin 2024 vazhdimisht ka luajtur një rol dekonstruktiv dhe vlerësim të ofertave në kundërshtim me LPP, dhe sipas bindjes së këtij Paneli Shqyrtues AK qëllimisht ka prolonguar këtë aktivitet të prokurimit, për të cilin konsideron se tani më veq se e ka humbur kuptimin dhe qëllimin për të cilin është iniciuar konform nenit 1 të LPP, i cili po ashtu ka kaluar edhe nëpër Gjykatat të Republikës së Kosovës.

Andaj, PSH tani në këtë fazë detyrohet të marrë për bazë arsyetimin e autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe mos ta prolongoj edhe për me tepër këtë procedurë, kështu që mbetet në përgjegjësinë e vet të AK KEK të anuloj këtë procedurë të prokurimit, përkundër të gjeturave të Paneleve Shqyrtues dhe ekspertit shqyrtues. Megjithatë, Paneli Shqyrtues duke u nisur nga neni 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”.

Detyrohet të marrë parasysh parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme. Kështu që. PSH vendos ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i njëjtë i cili i prinë edhe disa vendime paraprake që janë nxjerrë nga komisione të vlerësimit të cilët supozohen të jenë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”.

Atëherë në zabim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet të prokurimit edhe më tutje dhe paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK anulimi dhe zhvillimi i deritanishëm i kësaj procedure. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor, edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkesat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por e pa mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit ta kthejë sërish në rivlerësim dhe të prolongoj aktivitetin e prokurimit edhe më tutje.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin Autoritetit Kontraktues “Korporata Energjetike e Kosovës” lidhur me aktivitetin “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, vetëm për shkak se kjo lëndë ka humbur edhe qëllimin dhe arsyet për të vazhduar sërish me ri-vlerësim të ofertave.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim përveç nenit 1 dhe 6 mes tjerash edhe nenet 103 të Ligjit për Prokurim Publik të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër, si dhe në nenin 104 të LPP. Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - PATRONI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: